



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 1668 / Prot

03.03.23



Shkodër, më 03.03.2023



Nr. 211/1 Prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 13, datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 48 dhe 49, të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncensionit", të ndryshuar, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", tabela 6, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", pika 22, shkronja "j", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 1658 prot., datë 03.03.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.02.2023", shqyrtoi VKB nr. 13, datë 27.02.2023 "Për miratimin e dhënies në përdorim me afat 10 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 1.25 ha, për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse) dhe 7.487 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që dotë jepet në përdorim, në ngastrat nr. 20, 21, 21b, 22, 23, 24, 25, 42, 43b dhe 44, në ekonominë pyjore Gomsiqe".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

KËSHILLI I BASHKISE



V E N D I M

Nr. 13 datë 27.02. 2023

**“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.25 ha “për aerogjeneratorë(stacionet,objektetpërkatësetj)dhe 7.487 km rruge për tu lidhur me sipërfaqen qe do jepet në përdorim në ekonomine pyjore Gomsiqe”.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 27.02.2023, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në nenin 9 pika 1.2 shkronja a , nenin 54 shkronja el, neni nr 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore ligjit nr. 57/2020,datë 30.4.2020 “Për Pyjet”,neni 25, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, **me shumice votash:**

V E N D O S I

1. **“Dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.25 ha “për aerogjeneratorë(stacionet,objektetpërkatësetj)dhe 7.487 km rruge për tu lidhur me sipërfaqen qe do jepet në përdorim në ekonomine pyjore Gomsiqe ngastrat nr 20,21a,21b,22,23,24,25,42,43b,44.**
2. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore” shtojca nr 1 pika 8:6.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Ardian Çelepija**

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.03. 2023



Kryetari Këshillit  
**Mark Bisha**